



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 448 Prot.

Tiranë, më datë 25.07.2025

VENDIM

Nr. 406, datë 25.07.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.07.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Konceptit të sondazhit arkeologjik hartuar në kuadër të projektit “Objekt banimi dhe shërbimi me 4,5,6 dhe 7 kate dhe 3 kate nëntokë”, në njësinë administrative Durrës, njësia strukturore dr_ub_a2_393/4, durrës, zona kadastrale 8511, durrës, me numër pasurie 17/482, 17/931, 17/441, 17/416, 17/410, 17/406 në pronësi të: Sulejman Jollja, Lindita Ramazani, Beqir Jollja, Renata Maloku, Bardhyl Bregu, Lavdiye Mehmetaj, Agron Sherifi, Altin Teku, Monica D'ovidio, Kastriot Koçari, Alket Koçari, Petrit Katreli, Dallandyshe Jakupi, Valbona Xhaferri, Lodian Katreli, Gentian Katreli, Durrës, Brenda Zonës Arkeologjike “B” e qytetit të Durrësit, me zhvillues subjekti “**T&Xh**” sh.p.k., me rekomandimin:
 - Krahas sondazhit të propozuar në konceptin e hartuar nga subjekti i licencuar, pas prishjes së objekteve ekzistues të realizohen edhe 4 sondazhe shtesë;
 2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, për realizimin e sondazheve arkeologjike “Objekt banimi dhe shërbimi me 4,5,6 dhe 7 kate dhe 3 kate nëntokë” si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Rezultati i sondazheve arkeologjike do të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

